



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1226 / Prot
2

Rrëshen, më 26 . 03 . 2026

V E N D I M

Nr. 23 datë 19. 03. 2026

PËR

“CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIV DHE POLICISË BASHKIAKE, NË BASHKINË MIRDITË, NË ZBATIM TË VKM. NR. 103, DATË 11.02.2026, “PËR DISA NDRYSHIME NË VKM NR. 328, DATË 31.05.2023, “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVIL E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIV TË VETËQEVERISJES VENDORE”,
BASHKIA MIRDITË

Në mbështetje të nenit 54, pika “ç”, e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikës e Shqipërisë”, në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në ligjin nr. 35, datë.25.05.2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trejttimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të ë punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, në VKM nr. 103, datë 11.02.2026, “Për disa ndryshime në VKM nr. 328, datë.31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, relacionin nr. 1226 prot, datë 13.03.2026, së bashku me projekt-vendimin, e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin me ndryshim, në mbledhjen e datës 18.03.2026, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit*, për t’a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

V E N D O S I:

1. Të miratojë caktimin e kufijve të pagave, për punonjësit administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas pikës nr. 1/a të VKM nr. 103, datë 11.02.2026, si më poshtë:

Nr.	Emërtesa e pozicionit të punës	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë në lekë
-----	--------------------------------	---------------	------------------------------------

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

1	Specialist me arsim të mesëm profesional, kuzhinier, teknik të mesëm të specialiteteve të ndryshme, topograf	V	57 000
2	Kujdestare në qendrat e përkujdesit social, edukator në çerdhe	VII	57 000
3	Ndihmës kuzhinier	II	55 000
4	Pjatararës, lulishtarë, roje pa armë, punonjës shërbimi (përfshirë punëtorët e sektorit vaditës), sanitare/pastruese, centralist (receptionist), vrojtues pyjesh, punonjës me arsim të mesëm e të përgjithshëm	I	54 000
5	Shofer autoveture, furgon, autobus dhe automjete transporti deri në 2.5 ton	III	55 800
6	Llogaritar/e, ekonomist i mesëm, arkëtar, magazinier bashkia qendër, shofer autobuzi, specialist IT	VIII	57 000
7	Magazinier	IV	56 500

2. Të miratojë caktimin e kufijve të pagave të Policisë Bashkiake si më poshtë vijon;

Pozicioni i Punës

Paga e pozicionit në lekë

✦ Punonjësi i Policisë Bashkiake;.....57 000 lekë

3. Të miratojë pagesën e vjetërsisë 1% në vit, deri në 25 vite pune, mbi pagën e pozicionit për punonjësit e Policisë Bashkiake me arsim të mesëm
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë, nga data **1 Janar 2026** dhe përballohen nga transferta e akorduar për njësisë e vetëqeverisjes vendore, e miratuar me ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, si dhe të ardhura e veta të njësisë të vetëqeverisjes vendore”
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Burimeve Njerëzore Juridike, Drejtoria e Menaxhimit Financiar e Buxhetit, Agjencia e Arsimit, Sportit dhe Ndihmës Sociale & Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes Mirditë - A.P.P.M.M).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.


SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ




KRYETAR

Aleksandër RICA KU





REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 1226 / prot

Rreshen me 13.03 /2026

P/V E N D I M

Nr. 34 datë 13.03.2026

“PËR

CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE, TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË DHE TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE, NË BASHKINË MIRDITË, NË ZBATIM TË VKM NR.103, DATË.11.02.2026, “PËR DISA NDRYSHIME NË VËNDIMIN NUMËR 328, DATË 31.05.2023 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVË “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË, TË VETËQEVERISJES VENDORE TË NDRYSHUAR” DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.81, DATË.31.10.2024, PIKA 2

Mbështetur në nenin 54 pika “ç” ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në ligjin Nr. 9936 datë: 26.06.2008 “Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin Nr.68/2017 . “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr.35, datë 25.05.2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, në vkm nr.103, datë.11.02.2026, “Për disa ndryshime në vendimin numër 328, datë.31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, pika.1/a, referenca të tjera ligjore të ngjashme(orientuese), Këshilli i Bashkisë pasi shqyrtoi projekt-vendimin e Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I :

1. Të miratojë caktimin e kufirit të pagave për punonjësit administrativë sipas pikës nr.1/a të vkm nr.103, datë.11.02.2026.05.2023” si më poshtë:

Emërtimi i pozicionit	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë në leke
-----------------------	---------------	------------------------------------

Specialist me arsim te mesëm profesional, kuzhinier, teknike të mesëm të specialiteteve të ndryshme, topograf	V	57 000
Kujdestare në qendrat e përkujdesit social(educator në qerdhe)	VII	57 000
Ndihmës kuzhinier	II	55 000
Pjatararës, lulishtare, roje pa armë, punonjës shërbimi (përfshirë puntoret e sektorit vadites), sanitare/pastruese, centralist(receptioniste), vrojtues pyjesh, punonjes me arsim te mesem te pergjithshem	I	54 000
Shofer autoveture, furgon, dhe automjet transporti deri ne 2.5 ton.	III	55 800
Llogaritare,ekonomist i mesem , arketar, magazinier bashkia qender, shofer autobusi, specialist IT	VIII	57 000
Magazinier	IV	56 500

2-Të miratojë caktimin e kujfijve të pagave, të policisë bashkiake si më poshtë:

Pozicioni i Punës

Paga e pozicionit në lekë

► Punonjës i policisë bashkiake57 000 lekë

3-Të miratojë pagesën e vjetërsisë 1% në vit, deri në 25 vite pune, mbi pagën e pozicionit, për punonjësit e policisë bashkiake me arsim të mesëm .

4-Të miratojë ndryshimin e pikës 2, të vendimit të këshillit bashkiak nr.81, datë.31.10.2024. si më poshtë:

Klasa	Kategoria	Emërtesa e pozicionit të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës		Paga për pozicion
			Ishte	bëhet	
1	II-2	Drejtor drejtorie	1	Arsim i lartë	138 000
2	II-2	Drejtor agjensie	1	Arsim i lartë	138 000

3	III-2	Përgjegjës sektori Kryeinspektor,	1	Arsim i lartë	102 000

5-Të miratojë njësimin e pagës së Koordinatorit në kabinetin e Kryetarit të Bashkisë me pagën e pozicionit të Këshilltarit të Kryetarit të Bashkisë, kategoria III-2, sipas VKM-së nr.503, datë: 01.08.2024 (VKMnr. 328, datë.31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore").

6- Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi , fillojnë nga data e konfirmimit, te këtij vendimi nga Prefekti i Qarkut Lezhë dhe përballohen nga transfertat e akorduar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, miratuar në ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026, si dhe të ardhurat e veta të njësisë së vetëqeverisjes vendore".

7-Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

8-Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksander PICA KU

Paraqitën projektin

Sekretar i përgjithshëm: Artur Lazri

Përgj.sekt juridik dhe prokurimet: M.Topollaj

Përgj.sekt burimeve njerzore: Viktor Gjoka

Dr.Zhvill ekon dhe tatim taksa: Vjollca Gjoka

KRYETARI
Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MIRDITË

Nr. 1226 prot

Riëshen më. 13/03 /2026

RELACION

MBI ANALIZËN E PROJEKT VENDIMIT: PËR

CAKTIMIN E KUFIJVEVE TË PAGAVE, TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË DHE TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE, NË BASHKINË MIRDITË, NË ZBATIM TË VKM NR.103, DATË.11.02.2026, "PËR DISA NDRYSHIME NË VËNDIMIN NUMËR 328, DATË 31.05.2023 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVË "PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVEVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË, TË VETËQEVERISJES VENDORE TË NDRYSHUAR" DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.81, DATË.31.10.2024, PIKA 2

Për hartimin e këtij projekti jemi mbështetur në bazën ligjore si më poshtë:

Në nenin 54, pika "ç", e ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 datë: 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin Nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjin nr.35, datë.25.05.2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", në vkm nr.103, datë.11.02.2026, "Për disa ndryshime në vendimin numër 328, datë.31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika.1/a, referenca të tjera ligjore të ngjashme(orientuese).

Gjithashtu për hartimin e këtij projekt-vendimi jemi mbështetur në të dhënat e marra nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave, për gjendjen e fondeve, për rritjen e nivelit të

pagave brenda limitit të percaktuar nga VKM nr.103, datë.11.02.2026, "Për disa ndryshime në vendimin numër 328, datë.31.05.2023 të Këshillit të Ministrave "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", pika.1/a.

Theksojmë këtu se pjesa më e madhe e fondeve është nga gjendja e transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta të bashkisë, të trashëguara nga buxheti i vitit 2025 për buxhetin e vitit 2026.

Këtu sqarojmë se çelja e fondeve nga buxheti i shtetit për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme në zërin "transfertë e pakushtëzuar për rritjen e nivelit të pagave" për vitin 2026 është.....14 622 000 lekë.

Kjo transfertë është krejtësisht e pamjaftueshme për të realizuar rritjen e nivelit të pagës minimale për punonjësit administrativë nga 40000-47000(vkm 328, datë: 31.05.2023) në: 50000-57000(vkm 103, datë.11.02.2026), dhe rritjen e indeksimit të pagave të funksionarëve të zgjedhur, të nëpunësve civilë me 2.5% siç është përcaktuar në ligj.

Rritjen e nivelit të pagës minimale për punonjësit administrativë nga 40000-47000(vkm 328, datë: 31.05.2023) në 50000-57000(vkm 103, datë:11.02, 2026), bashkia Mirditë e realizoi në masën më të madhe me fondet e veta të trashëguara.

Fondi i total për rritjen e pagave gjendje, sipas të dhënave të Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave.....31 207 700 lekë, ku nga këto:

-Shtesa e TP për rritjen e nivelit të pagave (66 741 000-52 119 000).....14 622 000 lekë

-Transferte e përgjithshme e pakushtëzuar e trashëguar.....5 316 603 lekë

-Të ardhura të realizuara të vitit 2025 dhe të trashëguara për 2026.....11 296 097 lekë

TOTALI mbi të cilin u bë klasifikimi i rritjes së nivelit të pagave për punonjësit administrativë dhe policinë bashkiake dhe u hartua ky projekt vendim është31 207 700 lekë

HARTOI RELACIONIN
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Artur LAJRI

KONFIRMOI GJENDJEN E FONDEVE
DR.ZHVILL. EKON. DHE TATIM TAKSAVE
Vjollca Gjoka

MIRATOI
KRYETARI
Albert MËLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 21622111 www.bashkiamirdite.gov.al

